



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin

Nr. 40/L
23.07.2018

VENDIM

Nr. 40/L datë 13.07. 2018

“Për

Miratimin e kërkesës së Subjektit “Rozafa ” sh.p.k për marrje leje “Ujë për qëllime teknologjike” Pusi nr.2, në rrugën nacionale Elbasan – Librazhd, fabrika e përpunimit të peshkut, njësia administrative Labinot Fushë,bashkia Elbasan.

Në zbatim të ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”,neni 5 pika 2, neni 12 pika 2, neni 50 pika 2, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 416 datë, 13.05.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posacme, dokumentave shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”, Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 5 datë, 16.02.2016, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr 6. datë 16.02.2016, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor”, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin

VENDOSI:

Miratimin e kërkesës së Subjektit “Rozafa ” sh.p.k për marrje leje “Ujë për qëllime teknologjike”, Pusi nr.2 në rrugën nacionale Elbasan – Librazhd, fabrika e përpunimit të peshkut, njësia administrative Labinot Fushë,bashkia Elbasan.

Koordinatat e pusit janë :

X 45 56 642

Y 44 28 481

Z 159.50 m

Viti i hapjes së pusit	2016
Thellësia e pusit	80 ml
Kapaciteti i pusit	10.8 m³ /orë
Volumi maksimal i ujit që kërkohet për përdorim	0.00034 m³/s
Diametri i pusit	220 mm
Prurja mesatare	0.00034 m³/s
Prurja mesatare e muajit më të thatë	0.00034 m³/s
Sasia e ujit që kërkohet për përdorim	0.00034 m³/s

Kordinatat e pikës së shkarkimit :

Kanal shkarkimi X 45 56 733 Y 44 28 730 Z 152.50 m

Prurja që shkarkohet 0.00009 m³/s
Volumi që shkarkohet 8 m³/ditë

Vendimi hyn në fuqi pas zbardhjes së tyre formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin Elbasan

PËRGJEGJËS ABU

SHKUMBIN

Dashmir BIÇAKU



KRYETARI I KBU

SHKUMBIN

Maksim MALAJ

